



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 72/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|-----------------|------------|
| Gentian Këri | Kryetar |
| Spiro Kuro | Zv/Kryetar |
| Juliana Hoxha | Anëtar |
| Leonard Gremshi | Anëtar |
| Hektor Balluku | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 15.02.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF – 06905-08-24-2015, Loti I “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat*”, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.

Ankimues: “Zenit - 06” sh.p.k
Rr. “Myrteza Topi”, Ndërtesa 18, Hyrja 7, Ap. 38, Kodi Postar 1017, Nj.Bash. 9, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i qndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.08.2015, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat”, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH)..

II.2. Në datën 04.09.2015, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. “Zenit - 06” sh.p.k. | 475.500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Alb Supervizion – D.S.” sh.p.k. | 500.000 lekë, skualifikuar |
| 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Infratech” sh.p.k. & “Vler Invest” sh.p.k. | 567.900 lekë, kualifikuar |
| 4. “Novatech Studio” sh.p.k. | 662.445 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 10.09.2015 operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

II.4. Në datën 15.09.2015 operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

II.5. Me shkresën nr. 1738/2 prot., datë 17.09.2015 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën.

Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën në lidhje me arsyen e skualifikimit përsa i përket formularit të ofertës dhe nuk e ka pranuar atë në lidhje me shkakun e skualifikimit se *oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*.

II.6. Në datën 25.09.2015 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Në datën 20.10.2015, nëpërmjet vendimit K.P.P. 658/2015 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k., duke urdhëruar autoritetin kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e këtij operatori dhe për pasojë kualifikimin e tij.

II.8. Në datën 24.12.2015 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit me argumentin *“Arsyeja e anulimit të kësaj procedure është neni 24, pika 1, gërma “a” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit”*. Vendimi për anulimin e procedurës së prokurimit është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve të APP-së.

II.9. Në datën 29.12.2015 operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e anulimit.

Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]

Brenda afatit ligjor të ankimimit e kundërshtojmë këtë vendim duke kërkuar anulimin e tij. Kjo sepse:

Operatori ekonomik ankimues ka interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Vendimi i anulimit dëmton rëndë interes e ankimuesit sepse nëse nuk do të ishte marrë ky vendim për anulim, atëherë në zbatim të Vendimit KPP 658/2015 datë 20.10.2015, ankimuesi Zenit – 06 sh.p.k. do të shpallej fitues duke realizuar kontratën objekt prokurimi.[...]

Vendimi për anulim procedurës është marrës në kundërshtim me përcaktimet e ligjit të prokurimeve[...]

Në rastin konkret nga AK nuk janë zbatuar parimet e transparencës dhe të barazisë siç kërkohet në rregullat e prokurimit publik.

Konkretisht autoriteti kontraktor në vendimin e anulimit bën vetëm një copy të pikës 1 të nenit 24 të LPP por nuk jep asnjë shpjegim se cilat janë konkretisht këto shkaqe që kanë dalë jashtë kontrollit të AK.

AK në vendimin e anulimit bën vetëm copy të pikës 1 të nenit 24 të LPP por nuk jep asnjë shpjegim se cilat janë konkretisht këto shkaqe që nuk mund të parashikoheshin nga AK para fillimit të procedurës.

Theksojmë se njoftimi i procedurës së prokurimit është botuar në portalin e prokurimeve në datën 24.08.2015 dhe AK i janë dashur katër muaj kohë të kuptonte se kishte shkaqe që nuk i paska parashikuar në momentin e fillimit të procedurës.

Nuk jemi në kushtet e shkaqeve të parashikuara nga neni 24.1 të LPP sepse:

- *Anulimi i procedurës de facto është kundërshtim i vendimmarrjes dhe urdhërimit të organit më të lartë administrativ, vendimet e të cilit ishin të detyruara për zbatim nga AK.*

KPP me vendimet 658/2015 datë 20.10.2015 dhe KPP 658/3/2015 ka urdhëruar AK të kualifikojë ankimuesin Zenit 06 shpk dhe të vijojë me procedurën e prokurimit.

- *Kjo procedurë prokurimi objekt ankimi ka në objekt shërbim supervizioni, pra lidhet me kontratën e zbatimit të punimeve për të cilën AK ka zhvilluar procedurën dhe ka lidhur kontratë zbatimi. E përderisa nuk është anuluar kjo kontratë zbatim atëherë nuk ka asnjë shkak ligjor të anulohet procedura e supervizionit sepse ligji 8402/2005 Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve në ndërtim”, pamundëson kryerjen e këtyre punimeve të zbatimit pa supervizion.*

Pra vetëm në rastin se do të ishte anuluar kontrata e zbatimit për ndonjë nga shkaqet e parashikuara nga LPP mund të shërbente si shkak i paparishikueshëm dhe do të sillte edhe anulim të procedurës së supervizionit.

- *Anulimi i procedurës shkel parimin e barazisë të kërkuar nga neni 24/1 i LPP sepse LPP dhe rregullat e prokurimit kërkojnë trajtim të barabartë të operatorëve pjesëmarrës në procedurë prokurimi dhe nuk lejojnë AK të anulojë procedurën kur nga konkurimi i duhet të shpallë fitues një operator të cilin AK nuk e kishte paracaktuar apo parapëlqyer për ta shpallur fitues.*

- *Kualifikimi nga KPP i Zenit 06 sh.p.k. dhe detyrimi ligjor për ta shpallur atë fitues si oferta e kualifikuar me vlerën më të ulët, vërtet mund të ishte e paparishikuar nga AK para fillimit të procedurës së prokurimit, por kur mosparashikim nuk është shkak ligjor për anulim procedure.*

Në këtë rast për të patur mbështetje ligjore vendimi anulimit, AK mund të ndër marrë iniciativën ligjore “Për një ndryshim në ligjin e prokurimeve nr. 9643/2006,[...]”

Për sa më sipër, duke qenë se:

- *Vendimi për anulim të procedurës nuk ka asnjë shkak ligjor të parashikuar nga neni 24/1 i Ligjit të Prokurimeve,*
- *Nuk respekton parimin e transparencës (keni bërë vetëm copy të formulimit të pikës a të nenit 24/1 por nuk keni dhënë asnjë arsye reale kush ishte shkak të cilin nuk mund ta parashikonit në fillim të procedurës dhe që nuk varej nga ju)*
- *Nuk respekton parimin e barazisë në konkurim (operatori ankimues mund të jetë i padëshiruar ose më saktë nuk është ai që ju keni dëshiruar për këtë procedurë por ligji e trajton të barabartë me çdo pjesëmarrës tjetër)*
- *KPP me vendimet 658/2015, datë 20.10.2015 dhe KPP 658/3/2015 ka urdhëruar AK të kualifikojë ankimuesin Zenit 06 shpk dhe të vijojë me procedurën e prokurimit*
- *Përderisa nuk është anuluar kontrata e zbatimit për të cilin kërkohet shërbimi i supervizionit dhe ligji 8402/2005 “Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve në ndërtim”, pamundëson kryerjen e këtyre punimeve të zbatimit pa supervizion..*

Kërkoj pranimin e ankesës si të mbështetur në ligj dhe prova, vijimin e procedurës së zhvilluar mëdatë 4 shtator 2015 dhe duke shpallur fitues të ofertës Zenit – 06 sh.p.k. duke zbatuar vendimin e KPP.

II.10. Në datën 30.12.2015 autoriteti kontraktor ka depozituar pranë KPP shkresën nr. 2042/5 prot., datë 30.12.2015, me objekt “Dërgim informacioni”, mbi ecurinë e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.11. Operatori ekonomik ankimues sqaron se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga autoriteti kontraktor për ankesën e depozituar pranë tij për kundërshtimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

II.12. Në datën 14.01.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë kundërshtohet vendimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit.

II.13. Në datën 27.01.2016, nëpërmjet shkresës nr. 102/2 prot., datë 26.01.2016 me objekt: “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

Në informacionin e depozituar pranë KPP, autoriteti kontraktor sqaron se:

“[...]”

Në datën 07.12.2015 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave hartoi procesverbalin duke kualifikuar shoqërinë “Zenit – 06” sh.p.k. Oferta e kësaj shoqërie rezultoi anomalisht e ulët për të dy lotet dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të kërkojë argumentime për ofertat anomalisht të ulëta.

Në datën 11.12.2015 shoqëria “Zenit – 06” sh.p.k. paraqiti në Fondin Shqiptar të Zhvillimit argumentimet për ofertat anomalisht të ulëta. Ofertat u morën në dorëzim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i cili në datën 16.12.2015 filloi shqyrtimin e tyre.

Në datën 15.12.2015 Drejtoria e Infrastrukturës dërgoi pranë Njësisë Juridike dhe Prokurimit një kërkesë për anulimin e procedurës. Arsyet e dhëna për anulim në kërkesën e paraqitur janë si më poshtë:

Në datën 19.08.2015 është lidhur kontrata për objekt – zbatimin “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme Segmenti rrugor Lushnje – Berat, Loti i Parë” me kohëzgjatje të zbatimit 8 javë dhe kontrata për objekti – zbatimin “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme Segmenti rrugor Lushnje – Berat, Loti i tretë” me kohëzgjatje të zbatimit 12 javë.

Punimet nuk filluan menjëherë pas lidhjes së kontratës pasi nuk ishte përzgjedhur ende mbikqyrësi i punimeve për secilin objekt.

Procesi i prokurimit të mbikqyrjes së këtyre dy objekteve botuar në Agjencinë e Prokurimit Publik në datën 25.08.2015, për shkak të ankimimeve u zgjat përej parashikimeve.

Meqenëse për shkak të vonesës së përcaktimit të supervizimit të këtyre objekteve rrezikohej arritja e planit të disbursimeve financiare të fondeve për vitin 2015 si dhe humbte periodha optimale e mbjelljes së pemëve, doli e nevojshme të caktohej një inxhinier gjelbërimi i stafit të FSHZH për të kryer supervizimin e këtyre objekteve. Mbikqyrësi u caktua dhe në datën 10 nëntor 2015 filloi puna për zbatimin e objekteve.

Aktualisht përqindja e zbatimit të të dy objekteve është mbi 50%. Gjithashtu janë çertifikuar punimet dhe janë paguar situacionet pjesore për ato punime që janë kryer.

Duke patur parasysh afatin e kontraktuar të punimeve për Lotin 1 mbeten gjithsej edhe dy javë punime zbatimi, ndërsa për lotin 3 mbeten edhe 6 javë punime zbatimi, pra është një periudhë relativisht e shkurtër, përpara hyrjes në fazën e mirëmbajtjes. Për këtë arsye duke qenë se nuk janë shpallur ende fituesit për këto procedura mbikqyrje punimesh, si dhe duke patur parasysh që ndryshimi i mbikqyrës të punimeve kur ato janë në përfundim krijon probleme teknike, jemi të mendimit që mbikqyrja e këtyre dy objekteve të përfundohet nga supervizori i brendshëm, staf i FSHZH, i caktuar përkohësisht në këtë detyrë”.

Në datën 22.12.2015 Drejtori Ekzekutiv, bazuar në kërkesën e Drejtorit të Infrastrukturës urdhëron anulimin e procedurës. Procedura u anulua edhe në sistemin elektronik të prokurimit. Anulimi bazohet në nenin 24, pika 1 gërma a) të LPP[...].

[...]

Aktualisht punimet janë drejt përfundimit dhe mbikqyrja e punimeve është kryer nga një punonjës i autoritetit kontraktor.

Në datën 29.12.2015 operatori ekonomik “Zenit – 06” sh.p.k. paraqiti ankim pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit. Autoriteti kontraktor vendosi mos trajtimin e ankesave të paraqitura bazuar në nenin 24 pika 2 të LPP ku përcaktohet: “Autoriteti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni”.

[...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 24.08.2015, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH).

III.1.2. Në datën 04.09.2015, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit

III.1.3. Në datën 24.12.2015 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

Ky vendim është marrë me arsyetimin se në datën 19.08.2015 është lidhur kontrata për objekt – zbatimin “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme Segmenti rrugor Lushnje – Berat, Loti i Parë” me kohëzgjatje të zbatimit 8 javë dhe kontrata për objektin – zbatimin “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohshme Segmenti rrugor Lushnje – Berat, Loti i tretë” me kohëzgjatje të zbatimit 12 javë.

Punimet nuk filluan menjëherë pas lidhjes së kontratës pasi nuk ishte përzgjedhur ende mbikqyrësi i punimeve për secilin objekt.

Procesi i prokurimit të mbikqyrjes së këtyre dy objekteve botuar në Agjencinë e Prokurimit Publik në datën 25.08.2015, për shkak të ankimimeve u zgjat përtej parashikimeve. Meqenëse për shkak të vonesës së përcaktimit të supervizimit të këtyre objekteve rrezikohet arritja e planit të disbursimeve financiare të fondeve për vitin 2015 si dhe humbte periudha optimale e mbjelljes së pemëve, doli e nevojshme të caktohej një inxhinier gjelbërimi i stafit të FSHZH për të kryer supervizimin e këtyre objekteve. Mbikqyrësi u caktua dhe në datën 10 nëntor 2015 filloi puna për zbatimin e objekteve.

Aktualisht përqindja e zbatimit të të dy objekteve është mbi 50%. Gjithashtu janë çertifikuar punimet dhe janë paguar situacionet pjesore për ato punime që janë kryer.

Duke patur parasysh afatin e kontraktuar të punimeve për Lotin 1 mbeten gjithsej edhe dy javë punime zbatimi, ndërsa për lotin 3 mbeten edhe 6 javë punime zbatimi, pra është një periudhë relativisht e shkurtër, përpara hyrjes në fazën e mirëmbajtjes. Për këtë arsye duke qenë se nuk janë shpallur ende fituesit për këto procedura mbikqyrje punimesh, si dhe duke patur parasysh që ndryshimi i mbikqyrësit të punimeve kur ato janë në përfundim krijon probleme teknike, jemi të mendimit që mbikqyrja e këtyre dy objekteve të përfundohet nga supervizori i brendshëm, staf i FSHZH, i caktuar përkohësisht në këtë detyrë”.

Në datën 22.12.2015 Drejtori Ekzekutiv, bazuar në kërkesën e Drejtorit të Infrastrukturës urdhëron anulimin e procedurës. Procedura u anulua edhe në sistemin elektronik të prokurimit.

III.1.4. Në nenin 24, pika 1 “Anulimi i një procedure prokurimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

- a) Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;
- b) Nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve ligjore;
- c) Kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;
- d) Nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit;
- e) Nëse të gjitha ofertat e pranuar përmbyjnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
- f) Kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.”

III.1.5. Në nenin 60 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nxjerrë në zbatim të ligjit të mësipërm, është parashikuar shprehimisht: “Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;

- fondin e përllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare;

- llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj;

- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

III.1.6. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 24/1 të LPP-së për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Specifikisht autoriteti kontraktor nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1, gërma “a” të dispozitës së sipërcituar, pasi *shkaqet e pretenduara varen nga autoriteti kontraktor dhe, mëse të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik.*

Argumenti i autoritetit kontraktor se *meqenëse për shkak të vonesës së përcaktimit të supervizimit të këtyre objekteve rrezikohej arritja e planit të disbursimeve financiare të fondeve për vitin 2015 si dhe humbte periudha optimale e mbjelljes së pemëve, doli e nevojshme të caktohej një inxhinier gjelbërimi i stafit të FSHZH për të kryer supervizimin e këtyre objekteve,* nuk qëndron, pasi Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organi që kryen dhe menaxhon të gjithë procesin e prokurimit, bashkëpunon me të gjitha strukturat e tjera të përfshira në këtë proces prokurimi dhe duhet të kishte marrë parasysh shërbimet përkatëse përpara daljes së urdhërit të prokurimit.

III.1.7. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ky i fundit duhej të kishte zbatuar vendimin KPP 658/2015, datë 20.10.2015 dhe jo të ndërmerre hapa të tjerë të mëtejshëm në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Nisur nga informacioni i autoritetit kontraktor, i cili argumenton se rrezikohej arritja e planit, ndaj doli e nevojshme të caktohej një inxhinier nga stafi i FSHZH, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është përgjegjësia e tij si organi kompetent dhe përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit të parashikuara prej tij, ndaj nëse mbikqyrja e punimeve për këtë objekt mund të kryhej nga stafi i FSHZH (sikurse edhe po kryhet dhe është në përfundim të tij), atëherë vetë autoriteti kontraktor nuk duhet të bënte publikimin, shpalljen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, duke shkaktuar shpenzime procedurale për operatorët ekonomikë, investim në kohë, vonesa në realizimin e procedurave të mëparshme etj., por të menaxhonte më mirë situatën dhe kryerjen e shërbimeve me më pak kosto në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

III.1.8. Rezulton se, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe konkretisht rivlerësimit të saj në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik KPP 658/2015, datë 20.10.2015, autoriteti kontraktor me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv, ka anuluar procedurën e prokurimit bazuar në kërkesën e Drejtorit të Infrastrukturës duke argumentuar anulimin në bazë të nenit 24, pika 1 gërma a) të LPP.

Gjithashtu konstatohet se nuk i është kthyer asnjë përgjigje operatorëve ekonomikë ankimues me argumentin se bazuar në nenin 24 pika 2 të LPP ku përcaktohet: “Autoriteti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni”.

Sqarojmë se autoriteti kontraktor, në respekt të dispozitave ligjore në fuqi (ligjit dhe rregullave të prokurimit publik), edhe në rast se anulimi i procedurës është i justifikuar dhe argumentuar, sërish duhet të respektojë afatet e ankimit dhe të drejtën e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për t’u ankuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, dhe bazuar në nenin 63 të LPP ky i fundit shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

III.1.9. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anulimi i procedurës së mësipërme të prokurimit, duke mos e argumentuar dhe justifikuar atë bazuar në legjislacionin në fuqi, shkakton tejzgjatje të procedurës së prokurimit në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.10. Nga informacioni i autoritetit kontraktor konstatohet se në datën 24.12.2015 autoriteti kontraktor ka bërë anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit edhe në sistemin e prokurimeve elektronike. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kjo procedurë prokurimi është arkivuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nuk është më në listën e procedurave të prokurimit që zhvillon Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor se anulimi i procedurës dhe arkivimi i saj është kryer në kundërshtim të ligjit për prokurimin publik, pasi autoriteti kontraktor duhet të respektojë afatet e ankimit prej 7 ditë në autoritetin kontraktor dhe më pas prej 10 ditë që ligji i njej si të drejtë operatorit ekonomik ankimes për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë KPP-së.

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 63, pika 6, përcaktohet se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.1.11. Akoma edhe më tej referuar informacionit të autoritetit kontraktor konstatohet se në datën 10.11.2015 nga ana e tij për mbikqyrjen e këtij objekti, është caktuar një inxhinier nga stafi i FSHZH, ndërkohë që procedura ka qenë e pezulluar nga Komisioni i Prokurimit Publik (është ende e tillë) dhe më pas në datën 07.12.2015 është protokolluar pranë tij vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik KPP 658/3/2015, datë 03.12.2015 për mospranimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për rishikim vendimi.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në shkelje të afateve procedurale të parashikuara nga ligji dhe rregullat e prokurimit publik, ka avancuar me fazat dhe hapat e tjerë të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, ndërkohë që procedura e prokurimit ka qenë e pezulluar me vendimin 1551/1 prot., datë 28.09.2015.

III.1.12. Në nenin 19/1, pika 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”.*

Në nenin 64 pika 3 të LPP parashikohet se *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.*

*Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”. Në nenin 28, pika 2 të “VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit; b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim; c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit; d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit”. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të KPP. Kjo pozitë është parashikuar edhe nga *lex specialis*, i cili në mënyrë të shprehur parashikon në nenin 64/2 të tij se *Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin.*”*

III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura, autoritetet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me rigorozitet vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe të kryejnë rivlerësimin e ofertave konform konstatimeve të pasqyruara në këto vendime, ndërkohë që operatorët ekonomikë të cilët gjykojnë se interesat e tyre të ligjshme janë prekur nga këto procedura, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre, gjithnjë duke mbajtur në konsideratë afatet ligjore të përcaktuara.

III.1.14. Si konkluzion, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se në rastin konkret, në këto kushte, objektivisht është e pamundur realizimi i kësaj procedure prokurimi, tashmë për shkak të mosekzistencës së saj, sepse nga autoriteti kontraktor është kryer realizimi i saj me stafin e brendshëm të tij dhe referuar informacionit të këtij të fundit procedura objekt shqyrtimi është drejt përfundimit.

III.1.15. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor dhe zyrtarëve përgjegjës, pasi kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, duke mos zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në rast përsëritje të shkeljeve të konstatuara si më sipër, do të njoftohen organet kompetente për nisjen e hetimit administrativ dhe dhënien e masave përkatëse në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pushojë shqyrtimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat”, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pasi objekti për të cilin kishte filluar hetimi administrativ nuk ekziston më dhe është bërë i pamundur shqyrtimi për shkaqet e konstatuara më lart.
2. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 39 Protokoli,
Datë 14.01.2016



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri